

NDRYSHIMET MODERN NË SISTEMET BANKARE RËNDËSIA, SHKAQET DHE PASOJAT

Meqenëse jetojmë në shekullin e XXI-të, shekull ky i cili është duke u karakterizuar me një progres të hovshëm të teknologjisë dhe inovacionit, ku rëndësia e teknologjisë sidomos erdhi në shprehje gjatë pandemis Covid-19, është fakt që këto zhvillime i kanë dhënë një dimension tjetër mënyrës se si ne jetojmë, si informohemi, komunikojmë apo e perceptojmë realitetin. Për shumicën e qytetarëve sot është e vështirë të imagjinohet jetesa e përditshme por edhe puna profesionale pa përdorimin e pajisjeve të ndryshme elektronike të cilat janë bërë pjesë e pandashme e shoqëris.

Si çdo fushë tjetër, edhe sistemet financiare pothuajse në mbarë botën janë prekur nga zhvillimet teknologjike dhe janë përshtatur me teknologjitë më të fundit në fushën e komunikimit dhe të ofrimit të shërbimeve për klientët e tyre.

Gjithashtu edhe sistemi bankar nuk bënë përjashtim nga kjo tendencë e zhvillimit teknologjik pasi që te gjitha bankat në botë dhe po ashtu edhe në Kosovë tanimë veç se kanë zhvilluar teknologjitë më të avancuara me një intensitet dhe shpejtësi, të cilat janë te ngjashme me shumicën e vendeve të ndryshme evropiane e botërore të cilat i shfrytëzojnë këto lloj teknologjish edhe pse akoma ka mjaft vend për përmirësime në këtë fushë sepse avancimet e teknologjisë dihet se kur kanë filluar, por nuk dihet se kur do të ndalen, sepse zhvillimi i teknologjisë është i jashtzakonshëm.

Kandidati; Mentor Boroci

Mentori; Mejdi Bektashi